



*"QENDRA KOMBETARE
TERAPEUTIKE DHE
REHABILITUESE PER FEMIJET"*

Nr. 565 prot., dt. 10/05/2023

Nr. 94 prot., dt. 26/05/2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT "BARLETTI"
DHE
"QENDRES KOMBETARE
TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PER FEMIJET"**

Preambul: Universiteti "Barletti" i përfaqësuar nga Prof. Dr. Suzana Guxholli dhe "Qendra Kombetare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët" (QKTRF), e përfaqësuar nga Dr. Florida Dobi, në vijim të quajtura Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit arsimor në kuadër të modernizimit të tij;

Duke marrë në konsiderate politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi arsimor profesional të përgjegjshëm dhe modern për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimeve sociale, për përmirësimin shërbimit mjekesor dhe social për fëmijet e moshës 0-6 vjec;

Duke inkurajuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit arsimor;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyçe në ushtrimin e veprimtarisë së sistemit arsimor është efikasiteti dhe efënca e administratës arsimore të këtij Universiteti në përputhje me standardet dhe praktikatat me të mira vendase dhe ato perëndimore;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të Integritimit Evropian të sistemit arsimor në fushën e shërbimit social;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale, konkretisht, në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Per Arsimin e Larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise" dhe në Ligjin nr. Nr.10/107, datë 30.03.2009 "Per kujdesin Shendetsor ne Republiken e Shqiperise";

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas termave të dakortësuar në vijim:

Neni 1
Qëllimi dhe Objekti i bashkëpunimit

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim vendosjen e bashkëpunimit dypalësh nderinstitucional, midis Universitetit “Barleti” dhe “Qendres Kombetare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët” (QKTRF).
2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi ne projekte te perbashketa dhe realizimi i praktikave mësimore dhe atyre profesionale të studentëve të Universitetit “Barleti”, pranë QKTRF.

Neni 2
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Universiteti “Barleti” merr përsipër:

1. Të prezantojë paraprakisht numrin e studentëve dhe listën e plotë të tyre që do të kryejnë praktikën pranë “Qendres Kombetare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët”.
2. Të paraqesë kalendarin dhe programin e praktikës të miratuar në fillim të semestrit, që do të zhvillojnë studentët dhe ndjekjen e zbatimit të saj nga një përfaqësues i ngarkuari dhe i miratuar.
3. Të respektojë rregullat e parashikuara në rregulloret e brendshme si dhe legjislacionin në fuqi me anë të të cilit bëhet rregullimi i funksioneve të brendshme shëndetësore, përfshi respektimin e orareve të përcaktuara.
4. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
5. Shkëmbimin e ambjenteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mjedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institucioneve.
6. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm).

“Qendra Kombetare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët” merr përsipër:

1. Pranimin e studentëve për kryerjen e praktikës sipas programit të parashikuar.
2. Ofrimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e praktikës dhe mbikëqyerjen e ecurisë së praktikës me qëllim përfitimin e kualifikimit sa më cilësor.
3. Vënien në dispozicion të mjediseve të QKTRF për realizimin e praktikave mësimore, për realizimin e praktikave profesionale duke përfshirë edhe kapacitetet teknike në varësi të nevojave dhe mundësive, pajisjet etj.
4. Ndjekjen e praktikës dhe vlerësimin për çdo student në përfundim të praktikës, duke përshkruar nivelin e përvetësimit gjatë praktikës, nga një përfaqësues i ngarkuar dhe i miratuar nga të dy palët.
5. Punësimin eventual të studentëve.

Neni 4
Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 3 vjet nga data e firmosjes.
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për një afat tjetër 3 vjeçar.

Neni 5
Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti akademik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti akademik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti publikohet në faqet zyrtare të Paleve.
3. Të dy institucionet bien dakort që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme dhe ndjekja e zbatimit do të realizohet nga një përfaqësues i ngarkuar nga secili institucion.

Neni 6
Komunikimi midis palëve

1. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore, ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 diteve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmeren rast pas rasti.

Neni 7
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me mirëkuptim ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Cdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në cdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.
3. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej palëve, sjell si pasojë përfundimin e ligjshmërisë së saj.
4. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga pala që e kërkon, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.

5. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrindimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, tekstet e saj janë autentike dhe secila palë mban nga 2 (dy) kopje.

Nënshkruar në Tiranë, më _____ 2023.

**REKTORI
I UNIVERSITETIT "BARLETI"**

PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI



**DREJTORI I QENDRËS
KOMBETARE TERAPEUTIKE
DHE REHABILITUESE PER FEMIJET**

DR. FLORIDA DOBRI

